

## Interpretimi KIS 13 Njësitë ekonomike të bashkëkontrolluara

### *Kontributet jo monetare nga Sipërmarrësit*

#### Referencat

---

- SNK 8 *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*
- SNK 16 *Aktivitet afatgjata materiale*
- SNK 18 *Të ardhurat*
- SNK 31 *Interesat në Sipërmarrjet e përbashkëta*

#### Problemet

---

- 1 SNK 31.48 i referohet si kontributeve dhe shitjeve mes një sipërmarrësi dhe një sipërmarrjeje të përbashkët si vijon: ‘Nëse një sipërmarrës kontribon ose shet aktive tek një sipërmarrje e përbashkët, njohja e ndonjë pjese fitimi ose humbje nga transaksioni duhet të reflektojë thelbin e transaksionit’. Gjithashtu, SNK 31.24 përcakton se ‘një njësi e bashkëkontrolluar është një sipërmarrje e përbashkët që përfshin krijimin e një shoqërie aksionare, ortakërie ose njësie tjetër ku secili prej sipërmarrësve ka një interes’. Nuk ka një udhëzim të qartë mbi njohjen e fitimeve dhe humbjeve që vijnë nga kontributet në aktive jo-monetare të njësisve të bashkëkontrolluara (‘NJBK-ve’).
- 2 Kontributet në një NJBK, janë transferime të aktiveve nga sipërmarrësit në këmbim të interesave të kapitalit në NJBK. Këto kontribute mund të jenë në forma të ndryshme. Kontributet nga ana e sipërmarrësve mund të derdhen në momentin e krijimit të NJBK ose më pas. Konsiderata e marrë nga sipërmarrësi(sit) në këmbim të aktiveve të kontribuara në NJBK mund të përfshijnë mjete monetare ose konsideratë tjetër që nuk varet nga fluksi monetar i ardhshëm i NJBK (‘konsiderata shtesë’).
- 3 Problemet që dalin:
  - (a) nëse duhet të njihet nga sipërmarrësi në fitim/humbje, pjesa përkatëse e fitimeve ose humbjeve që vijnë nga kontributi në një aktiv jo-monetar në një NJBK në këmbim të një interesi kapitali në NJBK;
  - (b) si duhet të trajtohet nga sipërmarrësi kontributi shtesë; dhe
  - (c) si duhet të paraqitet në pasqyrat financiare të konsoliduara të sipërmarrësit fitimi ose humbja e përealizuar.
- 4 Ky interpretim merret me trajtimin kontabël të sipërmarrësit të kontributeve jo në mjete monetare në një NJBK në këmbim të interesave të kapitalit në një NJBK që përdor metodën e kapitalit ose konsolidimin proporcional.

## **Konsensus**

---

- 5 Gjatë zbatimit të SNK 31.48 për kontributet jo monetare në një NJBK në këmbim të interesave të kapitalit në NJBK, një sipërmarrës duhet të njohë në fitimin ose humbjen e periudhës pjesën e fitimit ose humbjes që i përket interesave të kapitalit të sipërmarrësve të tjerë me përjashtim të rastit kur:
- (a) risqe dhe përfitime të rëndësishme të pronësisë së aktivitetit jomonetar të kontribuar nuk janë transferuar tek NJBK; ose
  - (b) fitimi ose humbja nga kontributi jomonetar nuk mund të matet në mënyrë të besueshme; ose
  - (c) transaksioni i kontributit nuk ka thelb tregtar, siç përcaktohet termi në SNK 16.
- Nëse shfaqen situatat (a), (b) ose (c), fitimi ose humbja shihet si e përealizuar dhe prandaj nuk njihet në fitim ose humbje përveçse situatës së paragrafit 6.
- 6 Nëse përveç marrjes së interesave të kapitalit në NJBK, një sipërmarrës merr aktive monetare ose jomonetare, pjesa përkatëse e fitimit ose humbjes nga transaksioni duhet të njihet nga sipërmarrësi si fitim ose humbje.
- 7 Fitimet ose humbjet e përealizuara nga aktivitetet jomonetare të kontribuara tek NJBK duhet të eliminohen kundrejt aktiveve përkatëse sipas metodës së konsolidimit proporcional ose kundrejt investimit sipas metodës së kapitalit. Fitime ose humbje të tilla të përealizuara nuk duhet të paraqiten si fitime ose humbje të shtyra në pasqyrën e konsoliduar të situatës financiare të sipërmarrësit.
- 8-13 [Jo për Interpretim]

## **Data e miratimit**

---

Qershor 1998

## **Data e hyrjes në fuqi**

---

Ky Interpretim është i zbatueshëm për periudha vjetore financiare që fillojnë më 1 Janar 1999 ose më pas;. Nxitet zbatimi më i hershëm. Ndryshimet në politikat kontabël duhet të trajtohen në përputhje me SNK 8.

- 14 Ndryshimet në trajtimin kontabël të transaksioneve lidhur me kontributet jo në mjete monetare të cilësuar në paragrafin 5 duhet të zbatohen në mënyrë prospektive për transaksionet e ardhshme.
- 15 Një njësi duhet të zbatojë ndryshimet e bëra në këtë Interpretim nga SNK 16 për periudhat vjetore që fillojnë më 1 Janar 2005 ose më pas. Nëse një njësi zbaton Standardin 16 për një periudhë më të hershme, duhet të zbatojë këto ndryshime edhe për këtë periudhë më të hershme.